

DISCOVER
— ITS BEAUTY —

Pjesa 4



**PËRGJIGJE NDAJ PYETJEVE
KRITIKE TË NJERËZIMIT**

DR. NAXHI IBRAHIM



PËRGJIGJE NDAJ PYETJEVE KRITIKE TË NJERËZIMIT

Islami u përgjigjet pyetjeve më kritike dhe më domethënëse të njerëzimit, si këto:

- Cila është e vërteta?
- Kush na krijoi ne?
- A ka Zot?
- Kush është Zoti ynë i vërtetë?
- Cili është Profeti i fundit i Zotit?
- Kë duhet të adhurojmë?
- Kush jemi ne?
- Pse jemi këtu?
- Çfarë ndodh pasi të vdesim?
- Si do të jetë bota tjetër?
- Cili është stacioni ynë i fundit, Xheneti apo Xhehenemi?
- Si mund të arrijmë qetësi shpirtërore të vërtetë, sukses dhe lumturi reale?
- Si mund ta fitojmë botën e përjetshme?

Me mendjen dhe zemrën tënde të vendosura në kërkim të së vërtetës, të lutem lexo singlerisht dhe gjyko vetë.

TRUTH

A collage of torn paper with the word "TRUTH" repeated in a serif font. A large, central piece of paper is torn out, revealing the word "TRUTH" in a large, bold, serif font. The background consists of multiple layers of paper, each with the word "TRUTH" printed on it. The edges of the paper are ragged and torn, creating a layered, textured effect. The central piece of paper is a light cream color, contrasting with the darker, more saturated colors of the background layers. The word "TRUTH" is printed in a dark, bold, serif font, and the central piece is torn out in a way that leaves a large, irregular shape. The overall composition is abstract and evocative, suggesting themes of discovery, revelation, and the search for truth.

CILA ËSHTË E VËRTETA?

Islami na tregon se, Zoti i vetëm i vërtetë (Allahu) është Krijuesi i çdo gjëje. Zoti (Allahu) është i vetmi, që ka krijuar të gjithë njerëzit dhe kafshët; tokën dhe malet e saj; oqeanet dhe lumenjtë, bimët dhe pyjet, Diellin dhe Hënën, galaktikat dhe orbitat, ditët dhe netët. Të gjitha krijesat e tjera, duke përfshirë ato që i dimë dhe ato që nuk janë zbuluar ende, janë aspekte të krijimit të Tij të pafund.

Allahu ka krijuar gjithë jetën mbi Tokë dhe ka krijuar gjithë universin me kohë, hapësirë, energji dhe materie. Allahu e furnizon universin dhe çdo gjë në të, Ai kontrollon gjithçka që ndodh brenda tij.

Pavarësisht kësaj, disa njerëz ia cilësojnë ekzistencën e tyre 'rastit' apo 'natyrës'! Në kontekstin shkencor, ejani ta përkufizojmë se çka mendojnë ata me fjalën NATYRË! Çfarë është 'natyra'? A pajtoheni me mua se natyra përfshin: bimët, planetët, orbitat dhe galaktikat; livadhet dhe malet, oqeanet dhe lumenjtë; tokën, Diellin, Hënën, yjet dhe objektet e tjera? A janë krijuar këto gjëra vetvetiu? A i kanë krijuar krijesat këto?

Kurani i Madhërishtëm dhe universal shumë bukur na e tregon me këto ajete: ***“O njerëz! Adhuronit Zotin Tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të ruheni (nga të këqijat).”*** (2:21) ; ***“Ai i ka krijuar qiejt dhe tokën për të shpallur të Vërtetën...”*** (39:5); ***“Allahu është Ai, i Cili krijoi natën dhe ditën Diellin, Hënën, e të gjitha këto lundrojnë në gjithësi.”*** (21:33)

The background of the image is a deep space scene featuring a vibrant nebula with shades of purple, pink, and blue, set against a dark field of stars and distant galaxies. The text is centered over this celestial backdrop.

ALLAH

is the true

GOD

Shpesh ata që besojnë vetëm në natyrën thonë se nuk besojnë në Zot, thjesht sepse nuk mund ta shohin, ta prekin apo të provojnë ekzistencën e Tij.

Disa vite më parë, në Oregon, SHBA, fqinji im i vjetër më erdhi në shtëpi për vizitë. Ne biseduam për disa gjëra, njëra nga të cilat ishte edhe koncepti mbi Zotin. Duke e mohuar ekzistencën e Zotit, ai e goditi tavolinën e çajit duke thënë me emocione: “Unë besoj në këtë tavolinë, sepse mund ta shoh atë... mund ta ndiej!” Duke e arsyetuar, unë bëra me gisht te një llambë në dhomë dhe e pyeta: “A beson në rrymën elektrike?” Ai u përgjigj: “Sigurisht.” Unë e pyeta: “A mund ta shohësh fuqinë e energjisë, që po e prodhon dritën?” Ai u përgjigj se jo. Pastaj unë e pyeta prapë: “A e ke parë ndonjëherë, me sytë e tu, ajrin që thithim? A ke ndjenja? Cilat janë ngjyrat, format dhe madhësitë e tyre? Çfarë është gjumi? Cila është ngjyra dhe madhësia e tij? Në sa gjëra besojmë ne pa i parë në realitet?!”

Në një rast tjetër, unë takova një djalë të ri, me emrin Kris dhe gruan e tij, në një hotel në Oslo të Norvegjisë. Pas një diskutimi miqësor me të, unë e pyeta Krisin: “Cili është qëllimi i jetës tënde?” I habitur ai u përgjigj: “Kjo është hera e parë, që po e dëgjoj një pyetje të tillë!” Ai shtoi: “Mendoj se nuk kam ndonjë qëllim në jetën time”. Dhe si përfundim tha: “Unë nuk besoj në ndonjë zot.” Unë e pyeta, përse?, dhe ai u përgjigj: “Nuk e kam parë atë ende.” Duke komentuar përgjigjen e tij, e pyeta me buzëqeshje: “A e do gruan tënde? A mund ta shohësh këtë dashuri fizikisht? Çfarë ngjyre ka dashuria jote? Sa peshon kjo dashuri?” A mund ta imagjinosh si reagues Krisi dhe gruaja e tij?! Dukshëm, të mos



qenët i aftë ta shohësh apo ta matësh këtë dashuri abstrakte, nuk do të thotë që ta mohosh vërtetësinë dhe ekzistencën e saj.

Nga logjika e njëjtë, vetëm sepse nuk mund ta shohim Zotin me aftësitë dhe shqisat tona të kufizuara, të cilat nuk mund ta përfshijnë madhështinë e Tij, kjo nuk duhet të na bëjë që ta mohojmë ekzistencën e Tij.

Ekzistenca e Zotit është evidente dhe lehtësisht e dallueshme, në shenjat dhe provat e pakufishme, të manifestuara në krijimin e panumërt të atomeve, qelizave, indeve dhe muskujve, në çdo njeri dhe në çdo gjë, që Ai ka krijuar.

Mijëra Profetë të Zotit, si dhe miliarda ndjekës të tyre, gjatë historisë njerëzore e kanë pranuar ekzistencën e Zotit. Është shumë e arsyeshme ta shmangim dëshminë e atyre njerëzve dhe shenjave të panumërta, në favor të 'shkencës', kur në fakt teoritë shkencore vetëm përshkruajnë universin dhe nuk pyesin kush e ka krijuar këtë univers dhe si e ka bërë atë në mënyrën, se si është tani. Në fakt, teoritë shkencore tregojnë se mundësitë që universi ynë të ketë lindur nga 'rastësia' janë me të vërtetë të vogla dhe prapë 'rastësia' është sqarimi i vetëm, që ateistët mund të sjellin për ekzistencën dhe natyrën e universit; sipas tyre, 'ai thjesht është në këtë mënyrë'.

Duke marrë parasysh këtë, të lutem mendo, cili besim është më i logjikshëm: se rastësia e verbër udhëheq gjithçka, apo se universi është në këtë mënyrë që është tash, sepse është krijuar dhe kontrollohet nga Zoti?



KI PARASYSH KËTO PYETJE:

- **A është universi rezultat i një Krijuesi inteligjent apo u krijua nga rastësia e verbër?**
- **A e hedhin poshtë ‘shkenca’ dhe ‘teoria e evolucionit’ ekzistencën e Zotit?**

E vërteta në Islam është e thjeshtë. Ekziston vetëm një Zot, Krijuesi dhe Furnizuesi i universit (i bekuar dhe madhështor është Ai). Ne nuk duhet ta konsiderojmë askënd apo asgjë mbi Atë apo të barabartë me Atë. Zoti i vetëm i vërtetë (Allahu), na ka krijuar që ta njohim dhe ta adhurojmë vetëm Atë.

Ata që e adhurojnë Zotin si duhet, duke ndjekur urdhrat e Tij plotësisht, do të pranohen në jetën e përhershme në Xhenet. Në anën tjetër, ata që nuk i binden Zotit, duke ndjekur dëshirat e tyre epshore dhe mëkatore, duke përdorur dhe shtypur të tjerët, ku mendoni se pritët të përfundojnë ata? Ne nuk mund ta arrijmë lumturinë dhe qetësinë e vërtetë të mendjes ndryshe, vetëm se duke besuar dhe duke iu nënshtruar një Zoti të vërtetë (Allahut).



KUSH ËSHTË KY ZOT I VËRTETË?

Islami i përgjigjet kësaj pyetjeje jetike qartë, bukur dhe zbulon detaje rreth natyrës dhe cilësive të veçanta të Zotit të vetëm të vërtetë. Kurani madhështor thotë:

“Thuaj: “Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! 2. Allahu është Absoluti, të Cilët i përgjërohet gjithçka në amshim. 3. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. 4. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!”. (112: 1-4)

Kjo më lart është një kaptinë e plotë e Kuranit madhështor. Kjo kaptinë e mrekullueshme qartë dhe drejtë tregon të vërtetën absolute rreth një Zoti (Allahut), dhe natyrës së Tij të vërtetë; ajo u përgjigjet qartë pyetjeve të rëndësishme, që janë mister për miliona njerëz.

Disa nga cilësitë që e karakterizojnë, këtë Zot të vërtetë (Allahun) nga qeniet e tjera, që thonë (apo që u është thënë) se është Zoti, janë:

- Ky Zot i vërtetë është Krijuesi; Ai nuk është i krijuar apo i lindur.
- Ky Zot i vërtetë është i vetmi, nuk ka tjetër! Ai nuk ka partnerë apo ndonjë të barabartë me Të.
- Ky Zot i vërtetë është i padukshëm për ne, në këtë jetë.
- Ky Zot i vërtetë nuk manifestohet apo nuk kalon në ndonjë formë fizike në krijesat e Tij.
- Ky Zot i vërtetë është i përjetshëm; Ai nuk vdes apo ndryshon. Ai do të jetë gjithmonë aty për ne.
- Ky Zot i vërtetë nuk ka nevojë për asgjë dhe për askënd, sikurse nëna, gruaja, apo djali; Ai nuk ka nevojë për ushqim, pije apo ndonjë lloj ndihme tjetër. Të tjerët janë ata që kanë nevojë për Të.
- Ky Zot i vërtetë është unik në cilësitë e Tij. Asnjë nuk është si Ai dhe asnjë njeri apo karakteristikë kafshësh nuk mund t'i referohet Atij.



SI MUND TË ARRIJMË QETËSI SHPIRTËRORE, MENDORE DHE KËNAQËSI?

Me të vërtetë, Islami i njeh natyrat tona të brendshme dhe u përgjigjet pyetjeve tona. Ai u flet shpirttrave tanë, nevojave dhe prirejeve tona intelektuale. Allahu, Ai që i di fshehtësitë dhe mendimet më të thella që kemi në shpirt, në mendje dhe në zemra, na shpall ne fshehtësitë, që u sjellin qetësi dhe kënaqësi atyre. Këto janë disa nga çelësat dhe fshehtësitë që na ndihmojnë të arrijmë qetësinë e shpirtit:

- 1) Njihe Zotin tënd të vërtetë.
- 2) Besoje vetëm Atë.
- 3) Nënshtroju vullnetit të Tij dhe bindju Atij.
- 4) Beso në Profetët e Tij (duke përfshirë Profetin Muhamed).
- 5) Përmende Atë.
- 6) Kërko falje nga Ai.
- 7) Adhuroje vetëm Atë.
- 8) Dëshiro për të tjerët atë që dëshiron për vete.
- 9) Trego bujari ndaj të tjerëve dhe mundohu t'i bësh ata të lumtur.
- 10) Bëhu i sinqertë dhe i devotshëm.



Përmbledhje

Këto fshehtësi për arritjen e paqes mendore, qetësisë dhe kënaqësisë, si dhe arritjes së paqes shpirtërore, shoqërore globale, janë disa nga thesaret madhështore të Kuranit të madhërishëm dhe të thënieve profetike.

Si përfundim, Islami u përgjigjet pyetjeve madhore më të rëndësishme të njerëzimit dhe na mëson përmes dy burimeve autentike, Kuranit madhështor dhe thënieve profetike, që ne të mund të arrijmë paqe shpirtërore, lumturi dhe shpëtim vetëm përmes njohjes dhe besimit në Zotin e vetëm të vërtetë, me vullnet dhe me gjithë zemër. Ne duhet po ashtu të besojmë në të gjithë Profetët e Zotit të vërtetë (duke përfshirë Profetin Muhamed) dhe të ndjekim udhëzimin dhe mësimet e tyre të vërteta.



EMRAT DHE TERMAT BAZIKË ISLAMË

Allah: Në gjuhën arabe emri Allah është emri kryesor i Zotit të vërtetë, Krijuesit. Islami na mëson se Allahu është Zoti i vërtetë i gjithë njerëzimit. Arabët, hebrenj dhe të krishterë e përdorin po kështu këtë emër (Allah) për t'iu referuar Zotit dhe kjo fjalë përdoret për Zotin në Biblat e shkruara po ashtu në gjuhën arabe.


Muhamed: Profeti i fundit i Zotit të vetëm të vërtetë (Allahut), i dërguar i të gjithë njerëzimit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).

Kurani i Madhërishëm: Është fjala e fundit e Zotit të vetëm të vërtetë (Allahut), siç i është shpallur Profetit Muhamed.

Islami: Nënshtrim ndaj vullnetit të Zotit të vetëm të vërtetë (Allahut), Krijuesit.

Myslimani: Ai që i nënshtrohet vullnetit të Zotit të vetëm të vërtetë (Allahut), Krijuesit.

Xhamia (mesxhidi): I referohet një vendi të pastër të përkuljes (sexhdes), që përdoret nga myslimanët për lutje dhe adhurim.



DËSHMIA E BESIMIT HYRJA NË ISLAM

Dëshmoj se nuk ka tjetër të adhuruar me meritë përveç Allahut, dhe dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut.”

Në arabisht lexohet:




Që në shqip tingëllon sikurse më poshtë:

**ESH-HEDU EN LA ILAHE IL-LA ALLAH,
UE ESH-HEDU ENNE MUHAMMEDEN RESULULLAH!**



Kjo është dëshmia e besimit, që duhet të deklarojmë në mënyrë që të përqafojmë Islamin; ajo përmbledh të vërtetën, bukurinë dhe thjeshtësinë e Islamit.



A JENI ENDE KURESHTAR?

Nëse jeni kureshtar dhe të interesuar të zbuloni më shumë informacione dhe detaje rreth Islamit, ju lutem vizitoni faqen tonë:

www.discoveritsbeauty.com

Keni mirësinë të na dërgoni me e-mail pyetjet dhe kritikën tuaj:

info@discoveritsbeauty.com

SERITË E 'ZBULOJENI BUKURINË E TIJ'

- 1) Vetëm maja e ajsbergut
- 2) Feja e Ademit dhe Havasë
- 3) ABC-ja e Islamit
- 4) Përgjigje ndaj pyetjeve madhore të njerëzimit
- 5) Emrat e Tij të bukur
- 6) Shpallja e fundit
- 7) I Dërguari i fundit

WEBFAQET E DOBISHME ISLAME

<http://www.allahsquran.com>

<http://www.quranexplorer.com>

<http://www.islamhouse.com>

<http://www.edialogue.com>

<http://www.islamreligion.com>

<http://www.newmuslimguide.com>

<https://aboutislam.chat>

<https://guidetoislam.com>

DISCOVER
— ITS BEAUTY —

WWW.DISCOVERITSBEAUTY.COM



Scan it!

GLOBAL ACADEMY FOR TRANSLATION AND EDUCATION (GATE)
LONDON | THE UNITED KINGDOM

كتاب الإجابة عن تساؤلات البشرية الحاسمة باللغة الألبانية